



DREJTORIA E ARSIMIT

09 Nr 610-9095/2014

Datë: 21.8.2014

Mbështetur në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, në Ligjin për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës nr. 03/L-068 si dhe në UA nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve në klasë dhe raportin mësimdhënës-nxënës, Drejtoria e Arsimit shpall:

K O N K U R S

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË SHKOLLA TË MESME TË LARTA- NË GJIMNAZIN " LUIGJ GURAKUQI" DHE NË SHMP " FEHMI AGANI " NË KLINË PËR VITIN SHKOLLOR 2014/2015 – afati i gushtit

Konkursi shpallet me këto kushte dhe kriteret:

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2014/15, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9 të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe

Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2014/2015, në profilet ku ka vende të lira, bëhet më datën 22, 25 dhe 26 gusht 2014 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 27 gusht 2014. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.

Vërejtje: Sipas MASHT-it, në gjimnaz në klasën e dhjetë lejohen këto drejtime të gjimnazit: gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore dhe gjimnazi i shkencave natyrore, kurse në SHMP lejohen këto drejtime për klasën e dhjetë: Elektroteknikë, makineri, ndërtimtari, grafikë, komunikacion.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- | | | |
|--|-------|---------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (25%) | 25 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare në test | (15%) | 15 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (60%) | 60 pikë |

Informata shtesë mund të merren në drejtoritë e shkollave të mesme të larta në Klinë.

